

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

2 Nëntor, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorise Arsimore të Filadelfias,

Të Martën, 8 Nëntor, është dita e zgjedhjeve. Të gjitha ndërtesat e shkollave, përveç atyre që shërbejnë si vende votimi, do të mbyllën dhe nuk do të ketë klasa për nxënësit, pasi kombi ynë angazhohet në procesin demokratik të zgjedhjes së drejtuesve të tij të ardhshëm. Ky sezon zgjedhor ka qenë thellësisht përçarës, duke shtuar ankthet dhe streset me të cilat jemi përballur të gjithë për shkak të dhunës në qytetin tonë, pandemisë dhe më shumë. Si Drejtori Arsimore, është e rëndësishme që ne të bëjmë pjesën tonë duke mbështetur një kulturë të barazisë, përfshirjes dhe respektit për çdo nxënë, familje dhe anëtar të personelit.

Drejtorja jonë përfaqëson me krenari kombin tonë jashtëzakonisht të larmishëm -- që duhet përqaftuar dhe festuar. Megjithëse dallimet tona mund të na bëjnë të reagojmë ndryshe ndaj rezultateve të zgjedhjeve, shkollat dhe zyrat tona duhet të jenë strehë të sigurta pavarësisht nga rezultatet -- pa urrejtje, ngacmim dhe frikë. Kjo është një përgjegjësi që secili prej nesh e ndajmë.

Unë besoj me gjithë zemër se të rinjtë e angazhuar në mënyrë qytetare mund dhe do të formësojnë të ardhmen e kombit tonë, qytetit tonë dhe botës sonë. Prandaj, është e rëndësishme që edukatorët tanë të krijojnë hapësira të sigurta për diskutime të përshtatshme për moshën dhe të paanshme në klasë, të cilat i lejojnë nxënësit të shprehën në mënyra të shëndetshme dhe pa rrezik. Dhe është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne të gjithë të modelojmë se si të angazhohemi me njerëz me pikëpamje të ndryshme në një mënyrë të këndshme dhe tolerante. Këtu janë disa burime të dobishme që të gjithë mund t'i përdorim:

- [6 mënyra argëtuese për t'i mësuar fëmijët tuaj rreth votimit](#)
- [Le të votojmë! Bisedoni me Fëmijët për Votimin](#)
- [Drejtuesit Zgjedhor për Studentët ” iCivics”](#)

Fjalimi i bazuar në urrejtje, ngacmimet dhe sjelljet diskriminuese që zhvlerësojnë të tjerët janë të papranueshme kudo në drejtorinë tonë. Nëse jeni dëshmitar, bëheni të vetëdijshëm ose jeni objektiv i ndonjë prej këtyre sjelljeve, ju lutemi raportoni incidentin në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. Plotësoni online : [Bullying, Harassment and Discrimination Reporting Form](#)
2. Telefononi linjën telefonike të Sharjes/Ngacmimit në 215-400-SAFE
3. Email “Oficerit të Pajtuësishmërisë/Koordinatorit të Titullit IX drejtpërdrejt në : antiharassment@philasd.org

Faleminderit për punën tuaj për të kultivuar mendimtarë kritikë të plotë, pranues dhe të angazhuar në mënyrë qytetare. Ju lutemi mos harroni të VOTONI më 8 Nëntor!

Singerisht,

Tony

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias